

Shërbime Gjithëpërfshirëse për të Moshuarit



Një nismë gjithëpërfshirëse që synon të ofrojë kujdes të personalizuar, mbështetje sociale dhe promovimin e mirëqenies për të moshuarit në Bashkinë Vorë.

Të dhëna kryesore të projektit

Titulli i projektit: Shërbime Gjithëpërfshirëse për të Moshuarit

Kohëzgjatja: 3 vjet

Mbështetës: Fondi Social, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Bashkia Vorë

Agjencitë zbatuese: MIKE, Shtëpia e Zotërinjve, Bashkia Vorë

Numri i përfituesve: 300 të moshuar në Bashkinë Vorë

Shërbimet që ofrohen

- Vizita dhe vlerësim në banesë
- Ofrim i shërbimeve ditore në qendër
- Aktivitetet sociale, edukative dhe rehabilituese
- Mbështetje në komunitet dhe ndihmë në jetën e përditshme
- Përfshirje në aktivitete jashtëqendrore dhe sociale

Qëllimi i projektit

Të promovojë pavarësinë, dinjitetin, shëndetin dhe përfshirjen sociale të të moshuarve, duke forcuar kujdesin në shtëpi dhe në komunitet.

Mundësi punësimi

Në kuadër të projektit “Shërbime gjithëpërfshirëse për të moshuarit”, i cili realizohet në partneritet ndërmjet Qendrës MIKE, Shtëpisë së Zotërinjve dhe Bashkisë Vorë, shpallen pozicionet e mëposhtme për aplikim.

Punonjës Social

Detyrat dhe Kualifikimet:

- Realizimi i vlerësimeve sociale në terren dhe në qendër
- Hartimi i planeve individuale të ndërhyrjes për të moshuarit
- Ndjekja dhe dokumentimi i gjendjes sociale të përfituesve
- Bashkëpunimi me institucionet publike dhe komunitetin për referime dhe shërbime shtesë
- Diplomë në Shkenca Sociale
- Eksperiencë pune me grupmoshat vulnerabël (e preferuar me të moshuar)
- Aftësi të shkëlqyera komunikimi dhe empatie

Kujdestarë të Moshës së Tretë

Detyrat dhe Kualifikimet:

- Kujdes ditor dhe asistencë për të moshuarit në qendër ose në banesë
- Monitorimi i nevojave individuale për kujdes personal, ushqim dhe aktivitet fizik
- Mbajtja e të dhënave ditore dhe raportimi te personeli përgjegjës
- Eksperiencë në kujdesin ndaj të moshuarve ose trajnim profesional për kujdestar
- Durim, përkujdesje dhe përgjegjësi e lartë personale

Infermier(e)

Detyrat dhe Kualifikimet:

- Ofrimi i kujdesit shëndetësor bazë për të moshuarit
- Monitorimi i parametrave jetësorë dhe administrimi i terapisë sipas udhëzimeve mjekësore
- Bashkëpunimi me mjekë dhe fizioterapistë për ndjekje mjekësore të vazhdueshme
- Diplomë në infermieri
- Leje ushtrimi profesioni aktive
- Eksperiencë me të moshuarit përbën avantazh

Fizioterapist(e)

Detyrat dhe Kualifikimet:

- Ofrimi i seancave të fizioterapisë individuale dhe në grup
- Hartimi i planeve të ushtrimeve sipas diagnozës dhe gjendjes së të moshuarit
- Këshillimi për mënyrën e jetesës aktive dhe përmirësimin e lëvizshmërisë
- Diplomë në Fizioterapi
- Eksperiencë në punën me të moshuar ose me persona me aftësi të kufizuara
- Aftësi bashkëpunimi në ekip multidisciplinar

Psikolog(e)

Detyrat dhe Kualifikimet:

- Realizimi i vlerësimeve psikologjike dhe mbështetje emocionale për të moshuarit
- Organizimi i aktiviteteve për mirëqenie mendore dhe përfshirje sociale
- Konsulencë me familjarët dhe kujdestarët për situatat e vështira emocionale
- Diplomë në Psikologji Klinike ose Konsulencë Psikologjike
- Eksperiencë me të moshuar ose grupe vulnerabël
- Aftësi dëgjimi dhe ndërveprimi profesional

Dëshironi të na bashkoheni?

Apliko tani duke dërguar CV-në dhe letrën e motivimit në info@bashkiavore.gov.al ose të dorëzojnë fizikisht aplikimin në Bashkinë Vorë, brenda datës 06/06/2025.

Vetëm kandidatët që plotësojnë kriteret do të kontaktohen për intervistë.

JU MIREPRESIM!